Kronikë

Atentat në Vlorë, qëllohet me breshëri plumbash 33-vjeçari, plagoset rëndë! Gjendet e djegur në zonën e 'Ujit të Ftohtë' makina e autorëve, dy kallashnikovë brenda

Një person ka mbetur i plagosur mbrëmjen e sotme në Vlorë, pasi iu bë një atentat. Bëhet me dije se i plagosur ka mbetur Romeo Meçaj, teksa ngjarja u regjistrua pranë stadiumit. Policia ka gjetur një automjet të djegur në zonën e 'Ujit të Ftohtë', që i përkiste autorëve. Dyshohet se automjeti i përdorur në atentat, ishte vjedhur.

Redaksia
5 Mars, 20:45 | Përditesimi i fundit: 6 Mars, 06:57



Romeo Meçaj, 33 vjeç, ka mbetur i plagosur rëndë mbrëmjen e sotme në Vlorë, në një atentat mafioz pranë stadiumit "Flamurtari".

33-vjeçari po lëvizte me makinën tip "Land Rover" kur në drejtim të tij u shkrehën plumba kallashnikovi. Si pasojë e të shtënave, makina në lëvizje e të plagosurit përplasi disa mjete në afërsi, ndërsa nuk pati të tjerë të lënduar. Autorët dyshohet se e kanë pritur të fshehur Meçajn pranë stadiumit, ndërsa kanë pasur dijeni të lëvizjeve të tij.

LEXO EDHE:
Atentati ndaj 33-vjeçarit në Vlorë, shoqërohen 7 persona! Autorët kishin ndjekur lëvizjet e tij, e qëlluan me 15 plumba! Po hetohet për konfliktet për pazare droge

Pas të shtënave ata u larguan me shpejtësi, ndërsa dogjën automjetin e tyre në zonën e quajtur "Shtatë Pallatet", pranë Ujit të Ftohtë. Makina rezulton me targa të vjedhura. Pas këqyrjes, policia gjeti dhe sekuestoi brenda saj, dy kallashnikov të djegur, të cilët dyshohet se u përdorën për të qëlluar në drejtim të 33-vjeçarit Meçaj.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton



Romeo Meçaj jetonte në lagjen “Pavarësia” të Vlorës, ndërsa akoma mbetet e paqartë arsyeja e tentativës për ta eliminuar. Si pasojë e të shtënave, gjendja e tij paraqitet serioze, ndërsa është nisur me urgjencë drejt Spitalit të Traumës në Tiranë. Mësohet se plumbat e kanë kapur në afërsi të kraharorit dhe në gjymtyrët e poshtme.

Policia e Vlorës ka ngritur pika kontrolli në hyrje dhe dalje të qytetit, në përpjekje të identifikimit dhe kapjes së autorëve të atentatit. Zona ku ka ndodhur ngjarja është e survejuar me kamera sigurie, ndërsa po punohet për kapjen e detajeve të tyre për të shkuar drejtë gjurmëve të agresorëve.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 06:59

Momente pas atentatit/ I plagosuri transportohet drejt spitalit me makinën e policisë (VIDEO)

Ky është momenti ku i plagosuri i atentatit të Vlorës Romeo Meçaj transportohet nga policia me makinën e tyre drejt urgjencës së Vlorës.

Ora 21:18

Del foto, ja kush është 33-vjeçari që mbeti i plagosur në një atentat sot në Vlorë

Personi që shihni në foton më lart është Romeo Meçaj, 33-vjeçari që mbeti i plagosur rëndë mbrëmjen e sotme në Vlorë, si pasojë e një atentati.

Ora 20:58

Iu bë atentat në Vlorë, identifikohet 33-vjeçari që mbeti i plagosur! Në gjendje të rëndë në spital

Romeo Meçaj, 33 vjeç është personi që mbeti i plagosur në një atentat mbrëmjen e sotme në Vlorë. Mësohet se ai ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore.

BUNK'ART 1

J.SH./r.k./Shqiptarja.com

TAG: romeo mecaj | atentat | Vlore | plagosje

Komento

Komente

Herti: 06/03/2022 11:12

Djali Uzos esht ky

Përgjigju

shperthyesi: 06/03/2022 00:03

Cpaten keta? vlonjatet rrine gjithe diten mbi libra, frekuentojne vetem librari dhe debatojne vec per leteresi... Do jene te ardhur e jo vlonjeter...

Përgjigju

Shkodra: 05/03/2022 22:02

O vlora e keni humbur fare , keto heret e fundit po deshtoni vetem plagosje nuk po arrini te vrisni . Turp nuk ju falet si vlonjate

Përgjigju

Vlora: 05/03/2022 22:21

Jua kemi lene stafeten nga shkodra.

33 apo 30: 05/03/2022 21:55

Zoti-nja reporter-e ndaje mëndjen 30 apo 33 vjeç është hallexhiu i plumbave të marra?

Përgjigju

45vjecari: 06/03/2022 07:24

Kam idene se eshte 33 vjec me 30 plumba

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kush i fiton zgjedhjet e pjesshme vendore?

PS | PD | Shtëpia e Lirisë

Lajme të tjera

Kronikë

VIDEO/ Aksidentohet minatori në galerinë e kromit në Bulqizë, dërgohet me helikopter drejt Traumës

4 Mars, 13:22

Kronikë



I komunikuan se i ati duhet të paraqitej në komisariat, 22-vjeçarja qëlloi me thikë efektivin e policisë në Kamzë ! Vihet në pranga

3 Mars, 15:24

Kronikë

Shkon në katër numri i të arrestuarve në Vlorë! Report Tv siguron pamje brenda 'shtëpisë së barit'! Policia e zbuloi pas vjedhjes së energjisë elektrike

3 Mars, 11:21

Kronikë

Vlorë/ Mbolli 330 bimë kanabisi në banesë, arrestohet 40-vjeçari! Vjedhja e energjisë 'çoi' policinë te zbulimi i 'shtëpisë së barit'(VIDEO)

2 Mars, 13:01

Ekonomi

Lufta, pritet ndikim negativ në turizëm në Shqipëri! Operatorja turistike në Vlorë: Asnjë rezervim nga dy vendet në konflikt! Kreu i tur-operatorëve: Një vit më parë 40 mijë turistë ukrainas në Vlorë

Armand Xhelili

1 Mars, 16:16

Ekonomi

Lufta në Ukrainë, rritet çmimi i miellit me shumicë në Vlorë, një kuintal shkon 7 mijë lekë, tregtarët: E marrim më shtrenjtë nga fabrika

Armand Xhelili

1 Mars, 11:40

Kronikë

U kap me mbi 7 kilogramë në makinë, arrestohet 21-vjeçari në Vlorë

1 Mars, 11:16

Kronikë



Vranë 46-vjeçarin në banesën e tij në Vlorë për prishje të pazareve të drogës, burg për vrasësin dhe bashkëpunëtorin e tij

28 Shkurt, 14:39

Kronikë



U arrestua një ditë më parë vrasjen e Altin Alikajt në Vlorë, Report Tv siguron foton e autorit të dyshuar

27 Shkurt, 12:48

Kronikë

E fundit/ FNSH dhe 'Shqiponjat' pika kontrolli dhe patrullime në Elbasan, Berat e Vlorë në 'sitë' automjete të ndryshme

26 Shkurt, 18:46

Ekonomi

Michele Ricci, dhëndri italian që kultivon tokat në Vlorë: Qeveria të mbështesë fermerët

Armand Xhelili

26 Shkurt, 15:04

Politikë

Nisin përgatitjet për fillimin e sezonit turistik, Ahmetaj takim me sipërmarrës në Vlorë

26 Shkurt, 13:39

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje